

GJYKATA KOMUNALE PRISHTINË  
OPŠTINSKI SUD PRISHTINA

- 7 09 2011 10 50

MARRË NË DORËZIM  
PRIMLJENI

**GJYKATË KOMUNALE NË PRISHTINË**  
**-PROCEDURË PËRMBARUESE**  
**PRISHTINË**

**KREDITORI:** Muriithi Kagai, të cilin sipas prokurës e përfaqëson Interlex Associates l.l.c., me seli në rr. Andrea Gropa 35-1, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përmes avokatit Linn Slattengren.

**DEBITORI:** KEP TRUST me seli në rr. Bajram Kelmendi nr.16, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

**Vlera: €130,302.00**

**PROPOZIM PËR PËRMBARIM**

*Në bazë të dokumentit të besueshme për realizimin e kërkesës*

Debitori, në bazë të kontratës së datës 6 Maj 2010 të nënshkruar me Kreditorin, ka qenë i obliguar që këtij të fundit t'i bëjë pagesën e shumës e cila është përmbledhur në faturën që i është dërguar debitorit me datën 19.08.2011.

**Provë:** Fatura 338/11 e datës 19.08.2011

Edhe pas shumë kërkesave që ky borxh të kryhet, Debitori ka refuzuar të bëjë pagesën e borxhit të tillë edhe pse pagesën e tillë është dashur ta bënte muaj më parë dhe në përputhje me marrëveshjen mes palëve. Mirëpo, në kërkesën e fundit që i është bërë debitorit i është dhënë afati prej 7 ditësh për shlyerjen e borxhit, mirëpo kjo nuk është bërë.

**Provë:** Shkresa e Kreditorit dërguar Debitorit me datën 31.08.2011

Xhirollogaria bankare e Debitorit është kjo:

**Banka:** Procreditbank  
**Numri:** 1110-463265-0001-74

Ndërsa, xhirollogaria e autorizuar e kreditorit është kjo:

**Banka:** Raiffeisen Bank  
**Numri:** 1501001010656415.


Prandaj, duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë, kërkojmë nga gjykata që në përputhje me Nenin 30(2) të Ligjit Nr.03/L-008 për Procedurën Përmbartimore, të sjellë këtë:

## AKTVENDIM

**CAKTOHET** në dobi të Kreditorit, Muriithi Kagai, ndaj Debitorit, KEP TRUST me seli në rr.Bajram Kelmendi nr.16, Prishtinë, Republika e Kosovës, përmbartimi në bazë të dokumentit të besueshëm për mjetet në shumën prej €130,302.00, së bashku me shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit, duke bërë transferimin e kësaj shumë nga xhirollogaria bankare e Debitorit e cila është e hapur në Procredit Bank 1110-463265-0001-74 në xhirollogarinë e autorizuar nga Kreditori e cila është e hapur në Raiffeisen Bank me numër 1501001010656415.

Në Prishtinë,  
Me 7 Shtator 2011

**KREDITORI**, të cilin e përfaqëson  
Interlex Associates LLC, përmes  
Linn Slattengren, Avokat



**Shtojcë:**

1. Prokura
2. Fatura 338/11 e datës 19.08.2011
3. Shkresa e Kreditorit dërguar Debitorit me datën 31.08.2011

EDA. Nr. 3486/2011

GJYKATA KOMUNALE PRISHTINË  
OPÇTINSKI SUD PRISTINA  
27 03 2012 14 32  
MARRË NË DORËZIM  
PRILJENO

VIRTYT IBRAHIMAGA  
AVOKAT - ATTORNEY AT LAW

Law firm Virtyt Ibrahimaga  
Nr. regj./reg. no. OAK 1036/07

Rr. Fehmi Agani no.: 1/16  
10010 Prishtina

Tel.: + 381/38 227 358  
Fax: + 381/38 222 773

[info@lawfirm-vi.com](mailto:info@lawfirm-vi.com)  
[www.lawfirm-vi.com](http://www.lawfirm-vi.com)

Raiffeisenbank Pristina  
Swift Code: RBKORS22  
Account number:  
1501110000951351

Commercial Registration number:  
70480/33  
Managing Director: Virtyt Ibrahimaga

## GJYKATA KOMUNALE

## PRISHTINE

**Kreditori:** **Muriithi Kagai**, të cilin sipas prokurës e përfaqëson Interlex Associates sh.p.k., me seli në Rr. Andrea Gropa 35-1, 1000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përmes avokatit Linn Slattengren.

**Debitori:** **KEP Trust**, me seli në Rr. Bajram Kelmendi nr. 16. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Avokat Virtyt Ibrahimaga, rr. Fehmi Agani 1/16, 10010 Prishtinë.

Me aktvendimin EDA. Nr. 3486/201 të dt. 19.03.2012 gjykata ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit autentik.

Debitori në afatin ligjor kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm në mbështetje të nenit 54.1 lidhur me nenin 58. 4 të Ligjit nr. 03/L-008 për Procedurën Përmbarimore paraqet këtë

## P R A P S I M

1. Faturat e prezantuara nga Kreditori nuk paraqesin dokument të besueshëm në kuptim të nenit 30 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore sepse ato nuk derivojnë nga shkëmbimi komercial por janë pretendime për mospagesë të pagës nga marrëdhënia e punës dhe ligji i punës. Në mungesë të natyrës fiskale të këtyre faturave ato nuk përmbushin kriterin e dokumentit të besueshëm dhe nuk e kanë marrë cilësinë e përmbarueshmërisë. Për këto shkaqe, faturat e prezantuar nuk paraqesin si dokument të besueshëm është e pabazuar.

2. Neni 33 i ligjit për përmbarim kërkon reciprocitetin e detyrimeve dhe se propozuesi ka përmbushur obligimin e tij ligjor, gje që nuk dëshmohet me asnjë akt.

3. Përveç faktit se faturat e dorëzuara nuk paraqesin cilësinë e përmbareshmërisë sipas nenit 55.a i ligjit për përmbarimin, borxhi që parashtruesi i kërkesës nuk eksiton fare. Parashtruesi i kërkesës nuk ka punuar tek Debitori që nga dhjetori 2010. Më 13 dhjetor 2010, është shkëputur Kontrata e Kreditorit Zt. Kagai nga ana e KEP Trust. Ndërprerja e punës së Zt. Kagai është ratifikuar nga Bordi i Drejtorëve të KEP Trust, si dhe i është dërguar njoftimi për ndërprerje. Zt. Kagai nuk është ankuar në afatin e paraparë ligjor kundër vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës. Sipas nenit 11 të Rregullores për Ligjin themelor të punës 2001/27 i cili ka qenë ligj i aplikueshëm në momentin e shkëputjes së kontratës, afati i ankesës ka qenë një muaj dhe Zt. Kagai nuk ka ushtruar ankesë kundër një vendimit të tillë. Rrjedhimisht kërkesa e Zt. Kagai është parashkruar.

*Provë: Vendimi për shkëputjen e kontratës i datës 13.12.2010/ Tërheqja e padisë nga ana e propozuesit.*

Për arsytet e prezantuara më lartë, Debitori (Kundërshtuesi) paraqet këtë Kundërshtim dhe i propozon Gjykatës që për shkaqet e parapara në nenin 55(a) dhe 55(d) të Ligjit për Procedurën Përmbaremore në kombinim me nenin 57 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore të nxjerrë këtë:

#### **AKTVENDIM**

1. Hedhet poshtë si i palejueshëm propozimi për përmbarim i kreditorit konfrom nenit 57 të ligjit për procedurën përmbaremore, ngase faturat e prezantuara nga kreditori nuk paraqesin dokument të besueshëm sipas nenit 30 të ligjit për procedurën përmbaremore.
2. Shpenzimet e procedurës i bartë kreditori.

Alternativisht, në çoftë se gjykata konsideron se faturat e prezantuara paraqesin dokument të besueshëm sipas nenit 30 të ligjit për përmbarim, propozohet ky aktvendim alternativ:

#### **AKTVENDIM**

1. Propozimi për lejimin e propozimit përmbarim i kreditorit refuzohet.
2. Aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit të hjeket nga fuqia dhe që procedura të vazhdohet sipas rregullave të procedurës kontestimore.

Virtyt Ibrahimaga

Avokat

Fehmi Agani 416 10010 Prishtinë  
Tel: 044/36 493

Prishtinë, 27.03.2012

05-10-2012



C.nr.1957/12

## GJYKATËS KOMUNALE NË PRISHTINË REPUBLIKA E KOSOVËS

**PADITËSI:** **Bedan Muriithi Kagai**, që përfaqësohet nga Interlex Associates  
L.L.C., përmes avokatit Linn Slattengren, rr.Anurea Group S.A.,  
Prishtinë, Republika e Kosovës;

**E PADITURA:** **KEP Trust** (Kosovo Enterprise Programe), rr.Bajram Kelmendi  
nr. 16, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

### Procedura në Gjykatë:

1. Me 07.09.2011 kemi paraqitur propozim për përmbarrim pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës me të cilën kemi kërkuar kompensimin e shumës - borxhit prej 130,302.00 Euro nga xhirollogaria e debitorit, tani të paditurit, në xhirollogarinë e autorizuar të kreditorit, tani paditësit.
2. Me 19.03.2012 Gjykata Komunale në Prishtinë ka sjellë aktvendim me të cilin e ka aprovuar propozimin për përmbarrim të kreditorit. Me këtë aktvendim gjykata ka sqaruar se në rast të paraqitjes së kundërshtimit nga ana e debitorit propozimi për përmbarrim do të konsiderohet si padi dhe lënda do të procedohet në procedurën kontestimore. Ndaj këtij aktvendimi debitori, tani i padituri, ka paraqitur kundërshtim dhe lënda është përcjellë në procedurë kontestimore (kundërshtimin nuk e kemi pranuar asnjëherë, por vetëm jemi njoftuar gojarisht nga ana e administratës së gjykatës).
3. Prandaj, sot paraqesim këtë:

## **NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË PADISË<sup>1</sup>**

**Vlera: 1,235,706.00 €**

### Gjendja Faktike:

4. Paditësi është shtetas i huaj në Republikën e Kosovës ku ka themeluar marrëdhënie punë në bazë të kushteve të përcaktuara me kontratë dhe me Ligjin e Punës<sup>2</sup>, ndërsa e paditura është një OJQ e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me numër 5200066-1<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Meqë propozimi për përmbarrim konsiderohet si padi, atëherë ndryshimi dhe plotësimi i këtij propozimi është quajtur ndryshim dhe plotësim i padisë

<sup>2</sup> PROVA#1: Kontrata e punës e datës 01.01.2006 (versioni anglisht dhe shqip)

<sup>3</sup> PROVA#2: Certifikata e regjistrimit

5. Padiësi është i shkolluar për udhëheqjen e institucioneve mikrofinanciare dhe ka eksperiencë në operimin, mbikëqyrjen dhe themelimin e institucioneve mikrofinanciare në vendet në zhvillim. Menjëherë pas luftës, ai e ka themeluar KEP-in në Kosovë. Me 4 Mars 2002 KEP është regjistruar si OJQ në Kosovë. Pastaj, me 3 Prill 2002 është regjistruar edhe me Autoritetin Qendror Bankar në Kosovë (tani Banka Qendrore e Kosovës) që të operoj si institucion mikrofinanciar. Statusi i beneficuar publik KEP-it i është dhënë me datën 10 Qershor 2002. Në vitet në vijim, padiësi personalisht ka siguruar qasje në financimin ndërkombëtar për KEP-in dhe kështu e ka shndërruar këtë organizatë në organizatën më të madhe dhe më të suksesshme mikrofinanciare në vend. Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore në vitin 2010, KEP ka pas një vlerë neto të aseteve në shumën prej 14 milion euro dhe ka qenë institucioni më me perspektivë në Kosovë.
  
6. Me rritjen dhe përparimin e KEP-it, kompensimi për punën e padiësit është rritur. Me datën 04.05.2006 paga e tij është rritur në shumën prej 9,300.00 euro për muaj. Përveç kësaj, sipas kontratës së nënshkruar mes KEP dhe padiësit janë paraparë edhe një numër i caktuar i beneficioneve dhe është premtuar një “pako për pensionim”. Në mesin e beneficioneve kanë qenë edhe kthimi në vendlindje i gjësendeve nga Beogradi – që kërkon një kontejner 40ft për ti kthyer ato gjëra në shtetin e Kenisë. Shpenzimet për këtë gjë kapin shumën prej 5,000.00 eurosh. Pastaj është paraparë edhe kthimi në vendlindje i familjes që kushton 1,000.00 euro për person, që do të thotë gjithsejtë 5 person çmimi kushton 5,000.00 euro.
  
7. Në vitin 2006 kontrata e punës është plotësuar dhe ndryshuar duke reflektuar zhvillimet në KEP. Kontrata e punës e padiësit është ndryshuar me datën 6 Maj 2010<sup>4</sup>. Kjo kontratë e ka përcaktuar se në rast se ajo kontratë e punës përfundohet, përveç nëse përfundohet për shkak të punëtorit – padiësit, atëherë punëdhënësi “do t’ia paguaj Drejtorit Ekzekutiv, si dëmtshpërblim, pagën e tij bazë dhe shpenzimet e banimit për një vit plus pagën e mbetur që parashihet për periudhën e mbetur të kontratës; pastaj, edhe një pagesë shtesë prej maksimum 4 pagave mujore do të bëhet në vend të njoftimit.”
  
8. Me datën 05.11.2011 Banka Qendrore e Kosovës ka sjellë një vendim<sup>5</sup> me të cilin ka caktuar një administrator të përkohshëm në KEP Trust për shkak të mospajtimeve në mes të themeluesve të KEP Trust për emërimin e anëtarëve të bordit të drejtorëve. Me këtë rast administratori ka marrë pozitën e Drejtorit Ekzekutiv dhe ka filluar udhëheqjen e organizatës. Drejtori Ekzekutiv që e ka ushtruar funksionin deri në atë kohë nuk është njoftuar lidhur me statusin e tij. Atij nuk i është treguar nëse marrëdhënia e tij e punës vazhdon apo jo. Atij i është ndërprerë pagesa e pagës. Edhe pse ka kërkuar sqarime këto asnjëherë nuk i janë dhënë. Për këtë arsye padiësi ka paraqitur propozim për përmbarrim që tani është padi dhe kërkon miratimin e saj.

<sup>4</sup> **PROVA#3** – Aneksi i Kontratës së punës i datës 06.05.2010 (Versoni anglisht dhe shqip)

<sup>5</sup> **PROVA#4** – Vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës

## Arsyetimi Juridik:

9. Padiësi asnjëherë nuk është larguar nga puna, gjegjësisht nga pozita e tij si Drejtor Ekzekutiv i KEP. Përrjashtimi nga punë sipas ligjit të zbatueshëm mund të bëhet si në vijim:

### **Neni 72**

#### **Procedura para ndërprerjes së Kontratës**

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.
2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.
3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës.

### **Neni 73**

#### **Largimi i përkohshëm nga puna**

1. I punësuarit mund të largohet përkohësisht nga puna, kur:
  - 1.1. ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale;
  - 1.2. i punësuarit është në vuajtje të paraburgimit;
  - 1.3. kryen shkelje të obligimit të punës të përcaktuara me këtë ligj.

10. Asnjë pjesë e këtij ligji nuk është zbatuar. Në fakt, nuk ka pas asnjë bazë për përrjashtimin nga puna të Padiësit. Kontrata e punës e padiësit ka përfunduar me 31 Dhjetor 2011. Prandaj, ai ka të drejtë që ti paguhet paga bazë dhe shpenzimet e strehimit për një vit (vitin 2012) plus paga për pjesën e mbetur të kontratës (2011); pastaj, ai ka të drejtë në kompensim shtesë për maksimum 4 paga në vend të njoftimit. Meqë ai nuk ka pranuar asnjë njoftim për përrjashtim, por është tentuar që faktikisht dhe në mënyrë të heshtur të përrjashtohet nga organizata, ai ka të drejtë në kompensim për dy vite e katër muaj, apo një total prej 28 muajsh pagesë. Paga bazë plus shpenzimet e strehimit bëjnë gjithsejtë 13,130.00 euro në muaj. Totali për 28 muaj është 367,640.00 euro. Përveç kësaj marrëveshja ka paraparë edhe kompensim për shpenzimet e shkollimit dhe sigurimit shëndetësor. Shpenzimet e shkollimit për periudhën 2010-2011 është 20,262.00 euro. Sigurimi shëndetësor për 28 muaj është 14,000.00 euro (500 euro në muaj). Shpenzimet e kthimit në vendlindje janë 10,000.00 euro. Prandaj, kompensimi total bazë për padiësin duhet të jetë 411,902.00 euro. Meqë kjo pagesë është vonuar, Padiësi kërkon edhe kamatën për kompensimin e papaguar plus ndëshkimet.

11. Ligji i Punës lidhur me ndëshkimet thotë:

### **Neni 80**

#### **Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës**

1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose

1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

12. Është e qartë se mospagesa e këtij kompensimi është kundërligjore. Kjo për faktin se nuk ka pas përjashtim nga puna apo ndërprerje të marrëdhënies së punës. Prandaj, Padiësi ka të drejtë "jo më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit". Prandaj, minimum i kompensimit ashtu siq padiësi ka të drejtë është 823,804.00 euro plus kamata. Për shkak se trajtimi i padiësit ka qenë jashtëzakonisht jo etik dhe joprofesional kërkojmë nga gjykata që ta kompensoj atë sa trefishin e vlerës së kompensimit që atij i takon apo shumë më prej 1,235,706.00 euro.

13. Prandaj, kërkojmë nga gjykata që të sjellë këtë:


## A K T G J Y K I M

**APROVOHET** padia si e bazuar.

**DETYROHET** e paditura që t'ia paguaj padiësit shumë prej 1,235,706 EURO (një milion e dyqind e tridhjetë e pesë e shtatëqind e gjashtë euro) në emër të kompensimit për pagat bazë si dhe kompensimet e tjera të parapara me kontratën e punës së bashku me shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Në Prishtinë,  
Me 05.10.2012

**PADITËSI,**  
të cilin sipas prokurës e përfaqëson  
Interlex Associates përmes avokatit  
Linn Slattengren





**SHTOJCAT:**

- PROVA#1:** Kontrata e punës e datës 01.01.2006 (anglisht dhe shqip)
- PROVA#2:** Certifikata e regjistrimit
- PROVA#3:** Aneksi i Kontratës së punës i datës 06.05.2010 (anglisht dhe shqip)
- PROVA#4:** Vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës